



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 207 prot.

Tiranë, më 20.01.2018

Lënda: Mbi procedurën ligjore për aplikimet për "Leje zhvillimi/ndërtimi"

**DREJTORISË RAJONALE TË KULTURËS KOMBËTARE DURRËS
DREJTORISË RAJONALE TË KULTURËS KOMBËTARE SHKODËR
DREJTORISË RAJONALE TË KULTURËS KOMBËTARE BERAT
DREJTORISË RAJONALE TË KULTURËS KOMBËTARE GJIROKASTËR
DREJTORISË RAJONALE TË KULTURËS KOMBËTARE VLORË
DREJTORISË RAJONALE TË KULTURËS KOMBËTARE KORÇË**

Për dijeni: Sekretarisë Teknike të KKR, Institutit të Monumenteve të Kulturës

Sekretarisë Teknike të KKA, Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik

Në kuadër të procedurës së Derregullimit, në lidhje me aplikimet për "Leje zhvillimi/ndërtimi", sqarojmë se:

Ligji Nr. 9048, dt. 7.4.2003 "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), në nenet 30 dhe 47 përcakton se, KKR dhe KKA janë organet kolegjiale vendimmarrëse të ngarkuara me ligj për shqyrtimin dhe miratimin me shkrim të kërkesave për "Leje zhvillimi/ndërtimi", të cilat parashikojnë ndërhyrjet në territor.

Për rastet e mësipërme, subjektet aplikuese i drejtohen zyrtarisht me shkresat përkatëse Institutit të Monumenteve të Kulturës (Sekretaria Teknike e KKR) dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik (Sekretaria Teknike e KKA) duke shoqëruar kërkesën me dokumentacionin tekniko-ligjor pjesë e projektit përkatës.

Dokumentacioni lidhur me këto projekte nuk do t'i kërkohet subjektit privat, por do të përcillet zyrtarisht nga IMK dhe ASHA pranë Drejtorive Rajonale të Kulturës Kombëtare përkatëse, për dhënien e mendimit të tyre në lidhje me zhvillimin e këtyre projekteve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DRKKT-të me shkresë zyrtare duhet të depozitohen pranë IMK dhe ASHA, materialin përkatës të hartuar nga to, ku shprehin qëndrimin e tyre për projektet e paraqitura.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Oltjon MUZAKA

